ÇFARË NDODH PAS DIPLOMIMIT NGA SHKOLLA? REZULTATET NGA GJURMIMI I TË DIPLOMUARVE 2024-2025

Shkolla Profesionale Teknike Korçë

© 2026 Swisscontact

Rreth projektit "Aftësi për Punë" S4J

"Aftësi për Punë" S4J është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), i cili zbatohet në Shqipëri nga organizata Swisscontact. S4J adreson sfidat kryesore në Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP) në Shqipëri duke investuar për sigurimin e ndryshimeve sistematike, zhvillimin e kompetencave dhe fuqizimin e aktorëve. S4J mbështet ofruesit partnerë të AFP-së në drejtim të krijimit të lidhjeve të ngushta me kompanitë e sektorit privat dhe partnerë të tjerë, diversifikimit dhe përmirësimit të ofertës mësimore, aplikimit të metodave të reja të mësimdhënies dhe standardeve të cilësisë, realizimit të praktikave mësimore në mjediset e biznesit dhe zhvillimit e fuqizimit të institucionit.

Lista e tabelave

Tabela 1: Mbulimi i gjurmimit (2024–2025) 8
Tabela 2: Arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit (2024-2025) 14
Tabela 3: Niveli i përdorimit të njohurive të fituara gjatë studimeve (2024–2025) 15
Tabela 4: Shkalla e lidhjes së pozicionit aktual të punës me studimet (2024-2025) 15
Tabela 5: Perceptimi për sigurinë dhe kënaqësinë në punën aktuale (2024-2025) 20
Tabela 6: Periudha kohore në kërkim të një pune (2025-2025) 20
Tabela 7: Mënyrat e gjetjes së punës së parë (2024–2025) 22
Tabela 8: Ndihma e shkollës në gjetjen e punës së parë (2024–2025) 22
Tabela 9: Arsyet kryesore për ndjekjen e kualifikimeve të mëtejshme (2024–2025) 24
Tabela 10: Arsyet kryesore të papunësisë (2024–2025) 25
Tabela 11: Arsyet kryesore të mos kërkimit për punë (2024–2025) 26
Tabela 12: Përqindja e aspekteve ku ka nevojë për përmirësim në shkallë "shumë/jashtëzakonisht shumë" (2024–2025) 26
Tabela 13: Përzgjedhja e së njëjtës degë dhe shkollë sipas drejtimit (2024-2025) 28
Tabela 14: Planet e të diplomuarve për dy vitet e ardhshme (2024-2025) 29

Lista e figurave

Figure 1: Shpërndarja sipas gjinisë (2025) 8
Figure 2:Shpërndarja sipas drejtimeve (2025) 9
Figure 3: Vendbanimi i të diplomuarve (2024-2025) 9
Figure 4: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2025) 10
Figure 5: Punësimi kundrejt vetë-punësimit (2024-2025) 11
Figure 6: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas drejtimeve (2025) 11
Figure 7: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas gjinisë (2025) 12
Figure 8: Lidhja e punës me fushën e arsimit (2024-2025) 13
Figure 9: Lidhja e punës me fushën e arsimit sipas drejtimit (2024-2025) 14
Figure 10: Niveli i pagave një vit pas diplomimit, net (2025) 16
Figure 11: Niveli i pagave sipas drejtimit (2025) 17
Figure 12: Niveli i pagave sipas gjinisë (2025) 17
Figure 13: Punësimi me kohë të plotë përkundrejt punësimit me kohë të pjesshme (2024- 2025) 18
Figure 14: Madhësia e kompanisë (2024- 2025) 18
Figure 15: Lloji i kontratës (2025) 19
Figure 16: Ndërgjegjësimi rreth pagesës së sigurimeve nga punëdhënësi (2024- 2025) 19
Figure 18: Niveli i të diplomuarve pa punë që kërkojnë për punë (2024-2025) 25
Figure 19: Përzgjedhja e së njëjtës shkollë dhe degë (2024-2025) 27
Figure 20: Përzgjedhja e së njëjtës degë studimi dhe shkollë sipas gjinisë (2024-2025) 28

Tabela e përmbajtjes

Lista e tabelave 3
Lista e figurave 3
Tabela e përmbajtjes 4
Gjetjet kryesore 5
Të diplomuarit 2024-2025 8
Analiza e rezultateve 10
Statusi i punësimit 10
Lidhja e punës me fushën e arsimit 13
Përdorimi i njohurive dhe kompetencave të fituara në shkollë në vendin e punës 15
Niveli i pagave 16
Perceptimet mbi stabilitetin dhe kënaqësia në vendin e punës 20
Kohëzgjatja e gjetjes së punës së parë 20
Mënyrat e gjetjes së punës së parë 22
Të diplomuarit që ndjekin kualifikime të mëtejshme 24
Të diplomuarit pa punë 25
Propozimet për përmirësim në shkollë 26
Planet për të ardhmen 29

Gjetjet kryesore


- Në vitin 2025, 70.7% e të diplomuarve të gjurmuar ishin të punësuar/vetë-punësuar një vit pas diplomimit, kundrejt 62% në 2024 me një rritje prej rreth 8.7 pikësh përqindje. Niveli i papunësisë ra nga 31% (2024) në 22.4% (2025).
- Sipas drejtimit, në 2025 nivelet më të larta të punësimit u vunë re në Mekanikë (83.3%) dhe SHMT (77.8%), ndjekur nga Termohidraulikë dhe Elektroteknikë (75% secili) dhe Ndërtim (62.5%); TIK mbeti drejtimi me punësimin më të ulët (50%). Në 2024, renditja ishte e ndryshme: Termohidraulikë (75%) dhe Elektroteknikë (70%) kryesonin, ndjekur nga Mekanikë (66.7%), SHMT (62.5%), Ndërtim (58.3%) dhe TIK (50%).
- Lidhja e punës me fushën e arsimit u dobësua: nga 47.2% në 2024 në vetëm 34% në 2025. Të diplomuarit e vitit 2024 shpreheshin se puna që kryejnë lidhet me fushën e tyre të arsimit në përqindje më të lartë tek SHMT (80%), e ndjekur nga Elektroteknika dhe Ndërtimi (nga 57% secili), si dhe Mekanika (50%), ndërsa kjo lidhje ishte dukshëm më e ulët tek Termohidraulika (33%) dhe veçanërisht tek TIK (14%). Në vitin 2025, kjo lidhje u dobësua në pothuajse të gjitha drejtimet: SHMT mbeti drejtimi me përputhjen më të lartë, por në rënie të ndjeshme (71.4%), e ndjekur nga Elektroteknika (50%) dhe Ndërtimi (40%). Rënia më e theksuar u vu re tek Mekanika, ku në 2025 asnjë nga të diplomuarit e këtij drejtimi nuk e lidh punën me arsimimin e tyre, ndërsa Termohidraulika (16.7%) dhe TIK (20%) mbetën drejtimet me lidhjen më të dobët në të dy vitet.
- Përdorimi i njohurive dhe kompetencave të fituara gjatë studimeve ra lehtë, nga 44% (2024, "shumë/jashtëzakonisht shumë") në 34% (2025).
- Sipas rezultateve të gjurmimit për vitin 2025, struktura e të ardhurave mujore paraqitet si më poshtë: 41.9% e të diplomuarve (N=13) raportojnë të ardhura deri në 50,000 lekë, 19.4% (N=6) në intervalin 50,001–60,000 lekë, 12.9% (N=4) në intervalin 60,001–80,000 lekë, 9.7% (N=3) në intervalin 80,001–95,000 lekë, 6.5% (N=2) në intervalin 95,001–120,000 lekë, ndërsa 9.7% (N=3) raportojnë të ardhura mbi 120,000 lekë. Krahasimi i drejtpërdrejtë me vitin 2024 nuk është i mundur, pasi fashat e të ardhurave dhe paga minimale referuese ndryshuan mes viteve.
- Punësimi me kohë të plotë mbeti i lartë në të dy vitet, por ra lehtë nga 94% (2024) në 92% (2025).
- Siguria dhe kënaqësia në punë u ulën lehtë: 72% ndjeheshin "të sigurt/shumë të sigurt" në 2024, kundrejt 67.7% në 2025; kënaqësia ("të kënaqur/shumë të kënaqur") ra nga 75% (2024) në 84%.
- Në planet për të ardhmen, dëshira për të filluar biznesin personal mbeti prioriteti kryesor në të dy vitet dhe u rrit nga 45% (2024) në 50% (2025).

Çfarë është gjurmimi i të diplomuarve?

Monitorimi i treguesve kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit e një institucioni arsimor realizohet përmes 'studimeve gjurmuese' që ndjekin ose 'gjurmojnë' **të diplomuarit** pasi ata diplomohen. Studimet e gjurmimit ofrojnë një tablo më të qartë të performancës së të diplomuarve të arsimit profesional në tregun e punës, duke matur punësimin produktiv të të diplomuarve pas përfundimit të studimeve.

Të dhënat dhe rezultatet e gjurmimit përdoren për të rritur kuptueshmërinë mbi **relevancën e ofertës** për kualifikime duke kontribuar kështu në zhvillimin e aftësive të kërkuara nga tregu i punës dhe në pajisjen e nxënësve me njohuritë dhe aftësitë e duhura. Tematikat e gjurmimit janë të shumëfishta, por kryesisht përfshijnë pyetje që lidhen me tranzicionin nga institucioni arsimor në tregun e punës, kushtet e punës, përputhjen midis arsimit dhe punës aktuale, si dhe vlerësimin në retrospektivë të institucionit arsimor nisur nga përvoja e të diplomuarve.

Avantazhet e një sistemi gjurmimi në nivel ofruesi



Në këtë kuadër, shkolla **Teknike Profesionale Korçë**, me mbështetjen e projektit 'Aftësi për Punë' (S4J) ka ngritur një **sistem gjurmimi** në nivel ofruesi për të diplomuarit e saj. Ky sistem gjurmimi përmbush dy qëllime të rëndësishme:

a. Monitorimin e treguesve kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit e shkollës.
b. Vlerësimin e lidhjes (përputhshmërisë horizontale) midis arsimit dhe punës.

Zbatimi i procesit të gjurmimit në praktikë zhvillohet në **tre faza kryesore** siç është e ilustruar në diagramën më poshtë.



Në fazën e para-gjurmimit, që kryhet në majin e çdo viti shkollor, realizohet para-gjurmimi i maturantëve që pritet të diplomohen në qershor. Para-gjurmimi kryhet me anë të një pyetësori të strukturuar online. Anketa mbledh të dhënat e kontaktit të maturantëve, karakteristikat e tyre socio-demografike, si dhe planet dhe pritshmëritë e tyre të karrierës për të mundësuar kështu gjurmimin e tyre një vit më pas.
Në fazën e gjurmimit, që kryhet në qershorin e çdo viti shkollor realizohet gjurmimi i të diplomuarve nga shkolla një vit më parë. Të diplomuarit raportojnë mbi përvojën e kalimit në tregun e punës dhe bëjnë vlerësimin në retrospektivë të shkollës së tyre përmes një pyetësori të standardizuar online duke përdorur platformën Kobo Toolbox.

Në fazën përmbyllëse të procesit analizohen rezultatet e gjurmimit dhe prezantohen rezultatet. Pjesa më e rëndësishme e procesit është leximi i këtyre gjetjeve dhe reflektimi i brendshëm i institucionit mbi të dhënat dhe ndërmarrja e hapave konkrete si rrjedhojë.

Procesi i gjurmimit koordinohet nga **koordinatori i gjurmimit** me mbështetjen e Njësisë së Zhvillimit dhe mësuesve kujdestarë, nën kujdesin e projektit 'Aftësi për Punë'. Ky raport përmbledhës krahasues pasqyron rezultatet kryesore nga gjurmimi i dy brezave të diplomuar në vitin 2024 dhe në vitin 2025 në Shkollën Teknike Profesionale Korçë.

Të diplomuarit 2024-2025


Në vitin shkollor 2023-2024, në Shkollën Profesionale Teknike Korçë u diplomuan 79 nxënës, ndërsa në vitin shkollor 2024-2025 u diplomuan 65 nxënës (Shiko tabelën 1).

Tabela 1: Mbulimi i gjurmimit (2024–2025)

Brezi	Të diplomuar	Të anketuar	%
2023-2024	79	58	73%
2024-2025	65	58	89%

Nga të diplomuarit e vitit 2023–2024 u gjurmuan 58 nxënës (73%), ndërsa nga të diplomuarit e vitit 2024–2025 u gjurmua po ashtu i njëjti numër, 58 nxënës, që përfaqëson tashmë 89% të brezit. Në brezin 2024, 56 ishin djem (97%) dhe 2 vajza (3%); në brezin 2025, 54 ishin djem (93%) dhe 4 vajza (7%), një rritje e lehtë e përfaqësimit femëror, edhe pse ende shumë e ulët në terma absolutë.


Figure 1: Shpërndarja sipas gjinisë (2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt, baza 2024: N=58 (56 djem, 2 vajza).2025 (N=58);

Shpërndarja e të gjurmuarve sipas drejtimeve ndryshoi mes dy viteve. Në 2024: 17.2% Elektroteknikë, 13.8% Termohidraulikë, 10.3% Mekanikë, 20.7% Ndërtim, 13.8% SHMT dhe 24% TIK. Në 2025: 6.9% Elektroteknikë, 13.8% Termohidraulikë, 10.3% Mekanikë, 27.6% Ndërtim, 15.5% SHMT dhe 26% TIK, me Ndërtimin dhe TIK-un si drejtimet më të përfaqësuara në 2025, dhe një rënie të dukshme të peshës së Elektroteknikës.


Figure 2:Shpërndarja sipas drejtimeve (2025)



Shënim: *Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt, baza 2024 (N=58) ; 2025 (N=58).*

Të pyetur lidhur me vendbanimin, në 2024, 83% (N=48) e të diplomuarve të gjurmuar jetonin në Shqipëri dhe 17% (N=10) jashtë vendit. Në 2025, pjesa e atyre që jetojnë në Shqipëri u rrit në 89.7% (N=52), ndërsa 10.3% (N=6) jetonin jashtë vendit.

Figure 3: Vendbanimi i të diplomuarve (2024-2025)




Shënim: *Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt, baza 2024: N=58; 2025 (N=58).*

Analiza e rezultateve

Statusi i punësimit


Sipas rezultateve të brezit 2023–2024, nga 58 të anketuar, 45% (N=26) ishin të punësuar, 7% (N=4) të vetëpunësuar, 5% (N=3) student/kursant dhe 10% (N=6) të punësuar e njëkohësisht studentë; të papunë ishin 31% (N=18). Në brezin 2024-2025, nga po 58 të anketuar, 57% (N=33) ishin të punësuar, 7% (N=4) të vetëpunësuar, 5% (N=3) student/kursant dhe 7% (N=4) të punësuar e njëkohësisht studentë; të papunë mbetën 22.4% (N=13) me një përmirësim i ndjeshëm i nivelit të përgjithshëm të punësimit dhe një rënie e papunësisë.

Figure 4: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2025)



Shënim: *Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt, baza 2024 (N=58), 2025 (N=58).*


Figure 5: Punësimi kundrejt vetë-punësimit (2024-2025)



Shënim: *Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt, baza 2024 (N=36); 2025 (N=41).*

Sipas drejtimit (Figura 6), niveli i punësimit në 2024 ishte: Termohidraulikë 75%, Elektroteknikë 70%, Mekanikë 66.7%, SHMT 62.5%, Ndërtim 58.3% dhe TIK 50%; papunësia përkatëse ishte më e lartë në Ndërtim (41.7%), SHMT (37.5%), Mekanikë (33.3%), Elektroteknikë (30%), Termohidraulikë (25%) dhe TIK (21%). Në 2025, renditja ndryshoi: Mekanikë 83.3%, SHMT 77.8%, Termohidraulikë 75%, Elektroteknikë 75%, Ndërtim 62.5% dhe TIK vetëm 50% (me papunësi të lartë prej 66.7% në këtë drejtim — më e larta e vërejtur në të dy vitet). Në të dy vitet, të diplomuarit e drejtimit TIK janë të vetmit që vazhdojnë studime të mëtejshme paralelisht me punën.


Figure 6: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas drejtimeve (2025)



Shënim: *Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt, baza 2025 (Baza: TIK N=15; SHMT N=9; Ndërtim N=16; Mekanikë N=6; Termohidraulikë N=8, Elektroteknikë N=4); baza 2024: TIK N=14; SHMT N=8; Ndërtim N=12; Mekanikë N=6; Termohidraulikë N=8, Elektroteknikë N=10.*

Të ndara sipas gjinisë, në 2024, 46% e djemve ishin të punësuar, 32% pa punë dhe 5% në studime të mëtejshme, ndërsa 50% e vajzave ishin të vetëpunësuara dhe 50% punonin e studionin njëkohësisht. Në 2025, 72.2% e djemve ishin të punësuar dhe 20.4% pa punë, ndërsa vajzat ndaheshin në mënyrë të barabartë mes punësimit (50%) dhe papunësisë (50%).

Figure 7: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas gjinisë (2025)




Shënim: *Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt, baza 2025; M N=56; F N=2*

Lidhja e punës me fushën e arsimit

Të pyetur nëse puna aktuale lidhet me fushën e tyre të arsimit, 65.8% në 2025 u shprehën se puna nuk lidhet me fushën e tyre të arsimit,13 pike perqindje me më shumë se me 52.8% në 2024.


Figure 8: Lidhja e punës me fushën e arsimit (2024-2025)



Shënim: *Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt, baza 2024 (N=36); 2025 (N=41).*

Të diplomuarit e vitit 2024 shpreheshin se puna që kryejnë lidhet me fushën e tyre të arsimit në përqindje më të lartë tek SHMT (80%), e ndjekur nga Elektroteknika dhe Ndërtimi (nga 57% secili), si dhe Mekanika (50%), ndërsa kjo lidhje ishte dukshëm më e ulët tek Termohidraulika (33%) dhe veçanërisht tek TIK (14%). Në vitin 2025, kjo lidhje u dobësua në pothuajse të gjitha drejtimet: SHMT mbeti drejtimi me përputhjen më të lartë, por në rënie të ndjeshme (71.4%), e ndjekur nga Elektroteknika (50%) dhe Ndërtimi (40%). Rënia më e theksuar u vu re tek Mekanika, ku në 2025 asnjë nga të diplomuarit e këtij drejtimi nuk e lidh punën me arsimimin e tyre, ndërsa Termohidraulika (16.7%) dhe TIK (20%) mbetën drejtimet me lidhjen më të dobët në të dy vitet.

Figure 9: Lidhja e punës me fushën e arsimit sipas drejtimit (2024-2025)



Ndërkohë të pyetur lidhur me arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit (Shiko tabelën 2), të diplomuarit e brezit 2024 përmendën kryesisht pagën/kushtet më të mira të punës aktuale (53%) dhe pamundësinë për të gjetur një vend pune që lidhet me studimet (27%), krahas mungesës së dëshirës (13%) dhe mungesës së ofertave në rajon (7%). Në 2025, e gjithë kjo pyetje u përgjigj me të njëjtën arsye: pamundësia për të gjetur një vend pune që lidhet me studimet (100%).

Tabela 2: Arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit (2024-2025)

Arsyeja	2024	2025
Nuk gjeta një vend pune që lidhet me studimet e mia	27%	100%
Nuk dua të punoj në një punë që lidhet me studimet e mia	13%	-
Nuk ka oferta pune në fushën time në rajon	7%	-
Puna që kam më ofron pagë/kushte më të mira	53%	-

Shënim: *Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Baza: 2024 (N=15); 2025 (N=17).*

Përdorimi i njohurive dhe kompetencave të fituara në shkollë në vendin e punës

Të pyetur nëse njohuritë dhe kompetencat e fituara gjatë studimit i përdorin në vendin e punës (Shiko tabelën 3), 44% e të gjurmuarve në 2024 dhe 34% në 2025 pohojnë se i përdorin "shumë" ose "jashtëzakonisht shumë", me një rënie prej 10 pikësh përqindje. Pjesa e atyre që nuk i përdorin "aspak" u rrit nga 11% (2024) në 19.5% (2025).

Tabela 3: Niveli i përdorimit të njohurive të fituara gjatë studimeve (2024–2025)

Viti	Aspak	2	3	4	Jashtëzakonisht shumë
2024	11%	22%	22%	19%	25%
2025	19.5%	12%	34%	19.5%	14.6%

Shënim: *Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Baza: 2024 (N=36); 2025 (N=41).*

Të pyetur për lidhjen mes pozicionit të punës dhe studimeve të kryera (Shiko tabelën 4), 27.8% e të diplomuarve në 2024 dhe 29% në 2025 e vlerësojnë këtë lidhje me "shumë/jashtëzakonisht shumë" - nivel pothuajse i pandryshuar. Vlerësimet "pak/aspak" mbetën gjithashtu relativisht të qëndrueshme: 41.7% në 2024 dhe 36.6% në 2025.

Tabela 4: Shkalla e lidhjes së pozicionit aktual të punës me studimet (2024-2025)


Viti	Aspak	2	3	4	Jashtëzakonisht shumë
2024	17%	25%	31%	8%	19%
2025	9.8%	26.8%	34%	22%	7%

Shënim: *Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Baza: 2024 (N=36); 2025 (N=41).*

Niveli i pagave

Në 2005 për shkak të ndryshimit të pagesës minimale (nga 40,000 lekë në 50,000 lekë) nga 1 janar 2026, janë rishikuar kategoritë e pagave ne pyetësor. Në 2025: 29.7% paga minimale (e rritur në 50,000 lekë), 24.3% në fashën 50,001–60,000 lekë, 32.4% në fashën 60,001-80,000 lekë, 5.4% në fashën 80,001–95,000 lekë, 2.7% në fashën 95,001–120,000 lekë dhe vetëm 5.4% mbi 120,000 lekë, pra një përqendrim më të madh në fashat e mesme dhe një rënie të ndjeshme të pjesës me të ardhura shumë të larta.

Figure 10: Niveli i pagave një vit pas diplomimit, net (2025)



Shënim: *Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Grafiku pasqyron të dhënat e brezit 2025 (N=41); baza 2024: N=32.*

Sipas të dhënave të disagreguara sipas drejtimeve të studimit (shih Figurën 11), vërehen dallime të qarta në shpërndarjen e të ardhurave mujore nga puna ndërmjet të diplomuarve. Në kategorinë e të ardhurave deri në 50,000 lekë, përqindja më e lartë vërehet tek të diplomuarit në Elektroteknikë (50.0%), ndjekur nga SHMT (43%), TIK (40%), Mekanikë (33.3%), Termohidraulikë (16.7%), dhe Ndërtim (11%), ndërkohë që në drejtimin Ndërtim nuk raportohet asnjë i diplomuar në këtë kategori. Sa i përket të ardhurave 50,001–60,000 lekë, kjo kategori është më e përhapur tek të diplomuarit në Termohidraulikë (50%), Ndërtim (33%), TIK (20%) dhe SHMT (14.3%). Në drejtimet Elektroteknikë dhe Mekanikë nuk raportohen të diplomuar në këtë interval page.


Në kategorinë 60,001–80,000 lekë, vetëm të diplomuarit në Mekanikë (66.7%), Ndërtim (44.4%), SHMT (42.9%) dhe TIK (10%) raportojnë të ardhura në këtë nivel, ndërsa drejtimet e tjera nuk paraqesin përfaqësim.

Në intervalin 80,001-95,000 lekë, ka vetëm të diplomuar në Elektroteknikë (50%) ndërsa drejtimet e tjera nuk paraqesin përfaqësim.

Në kategorinë 95,001–120,000 lekë, vetëm TIK paraqet përfaqësim, me 10% të të diplomuarve në këtë drejtim.

Së fundi, të ardhurat mbi 120,000 lekë dominohen nga drejtimet Ndërtim (11%) dhe TIK (10%), duke treguar potencial dukshëm më të lartë të këtyre profileve për paga të larta. Në drejtimet e tjera nuk raportohet asnjë i diplomuar me të ardhura mbi 120,000 lekë.


Figure 11: Niveli i pagave sipas drejtimit (2025)



Shënim: *Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt, 2025 (Baza: TIK N=15; SHMT N=9; Ndërtim N=16; Mekanikë N=6; Termohidraulikë N=8, Elektroteknikë N=4).*

Në 2025, i gjithë kampioni femëror (100%) vazhdon të marrë deri në 50,000 lekë; te djemtë, 25.7% marrin deri në 50,000 lekë, 25.7% në 50,001–60,000, 34.3% në 60,001–80,000, 5.7% në 80,001–95,000, 3% në 95,001–120,000 dhe 5.7% mbi 120,000 lekë.

Figure 12: Niveli i pagave sipas gjinisë (2025)




Shënim: R*ezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt, 2025 (Baza: M N=39; F N=2)*

Kushtet e punës

Të pyetur lidhur me karakteristikat kryesore të punës, 94% e të diplomuarve në 2024 punonin me kohë të plotë (3% me kohë të pjesshme, 3% me kohë të plotë sezonale). Në 2025, 92% punonin me kohë të plotë dhe 8% me kohë të pjesshme.


Figure 13: Punësimi me kohë të plotë përkundrejt punësimit me kohë të pjesshme (2024- 2025)



Shënim: *Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt, baza 2024: N=32; 2025 (N=41).*

Për sa i përket madhësisë së kompanisë, në 2024, 28% e të diplomuarve punonin në kompani me 1–4 punonjës, 28% me 5–9 punonjës, 28% me 10–49 punonjës dhe 16% me mbi 50 punonjës — shpërndarje relativisht e balancuar. Në 2025, mikrondërmarrjet (1–4 punonjës) u bënë mbizotëruese (59.5%), ndjekur nga kompanitë me 5–9 punonjës (27%), 10–49 punonjës (2.7%) dhe mbi 50 punonjës (10.8%).

Figure 14: Madhësia e kompanisë (2024- 2025)




Shënim: *Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt, baza 2024: (N=32); 2025 (N=41);*

Lidhur me llojin e kontratës, në 2024, 19% e të gjurmuarve kishin kontratë me afat të caktuar, 38% me afat të pacaktuar, 6% ishin në praktikë dhe 38% punonin pa kontratë. Në 2025, situata ndryshoi:

24.3% me afat të caktuar, po aq (24.3%) me afat të pacaktuar, 11% në praktikë dhe 40.5% pa kontratë - pjesa e punësimit pa kontratë mbetet e lartë dhe në rritje të lehtë.


Figure 15: Lloji i kontratës (2025)



Shënim: *Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt baza 2024: N=32; 2025 (N=41);*

Lidhur me pagesën e kontributeve të detyrueshme nga punëdhënësi, 69% e të diplomuarve të punësuar në 2024 deklaruan se iu paguheshin, kundrejt 75.7% në 2025 - një përmirësim. Pjesa e atyre pa informacion mbi këtë çështje u rrit lehtë, nga 5% (2024) në 11% (2025), ndërsa ata që deklaruan se nuk iu paguheshin ranë nga 12% (2024) në 13.5%.

Figure 16: Ndërgjegjësimi rreth pagesës së sigurimeve nga punëdhënësi (2024- 2025)



Shënim: *Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt baza 2024: N=32; 2025 (N=41).*

Perceptimet mbi stabilitetin dhe kënaqësia në vendin e punës

Të pyetur se sa të sigurt dhe të stabilizuar ndjeheshin në vendin e tyre të punës, 72% e të diplomuarve në 2024 u shprehën se ndjehen "të sigurt ose shumë të sigurt", kundrejt 67.7% në 2025 (lehtë në rënie). Pjesa e atyre që ndjehen "shumë të pasigurt ose të pasigurt" u rrit lehtë, nga 16% (2024) në 19% (2025).

Të pyetur lidhur me kënaqësinë në vendin e punës, 75% e të diplomuarve në 2024 shprehen se ndjehen "të kënaqur ose shumë të kënaqur", kundrejt 83.8% në 2025 - një përmirësim. Vetëm 6% (2024) dhe 5.4% (2025) shprehen "shumë të pakënaqur".

Tabela 5: Perceptimi për sigurinë dhe kënaqësinë në punën aktuale (2024-2025)

Treguesi	2024	2025
Shumë i/e pasigurt	13%	5.4%
I/e pasigurt	3%	13.5%
As i/e sigurt as i/e pasigurt/ neutral	13%	13.5%
I/e sigurt	34%	46%
Shumë i/e sigurt	38%	21.6%
Shumë i/e pakënaqur	6%	5.4%
I/e pakënaqur	-	2.7%
As i/e kënaqur as i/e pakënaqur/ neutral	19%	8%
I/e kënaqur	41%	59.5%
Shumë i/e kënaqur	34%	24.3%

Shënim: *Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Baza: 2024 (N=32); 2025 (N=41).*

Kohëzgjatja e gjetjes së punës së parë

Të pyetur për kohën e pritjes deri sa filluan punën e tyre të parë, në 2024, 56% u përgjigjën se e kishin gjetur punën para diplomimit, 6% brenda 1 muaji, 9% brenda 1–3 muajve, 9% brenda 3–6 muajve, 6% brenda 6–9 muajve dhe 13% brenda 9–12 muajve. Në 2025, pjesa e atyre që gjetën punë para diplomimit ra në 51.4%, ndërsa 19% u punësuan brenda 1 muaji (rritje e dukshme nga 6% në 2024), 16% brenda 1–3 muajve, 5.4% brenda 3–6 muajve, 2.7% brenda 6–9 muajve dhe 5.4% brenda 9–12 muajve.

Tabela 6: Periudha kohore në kërkim të një pune (2025-2025)

Periudha	2024	2025
Para diplomimit	56%	51.4%

Brenda 1 muaji	6%	19%
1–3 muaj	9%	16%
3–6 muaj	9%	5.4%
6–9 muaj	6%	2.7%
9–12 muaj	13%	5.4%

Shënim: *Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt, baza 2024: N=32; 2025 (N=41).*

Mënyrat e gjetjes së punës së parë

Lidhjet personale mbeten forma mbizotëruese e gjetjes së punës së parë në të dy vitet: 69% e të diplomuarve në 2024 dhe 62% në 2025 gjetën punë nëpërmjet njohjeve, lidhjeve familjare dhe miqve. Njoftimet për punë (internet, media sociale, gazetë) u rritën lehtë si kanal, nga 13% (2024) në 16% (2025), ndërsa kontaktimi direkt me punëdhënësin mbeti relativisht i qëndrueshëm (6% në 2024, 5% në 2025). Në 2025 u shfaq edhe praktika profesionale në biznes si kanal i ri (5%).

Tabela 7: Mënyrat e gjetjes së punës së parë (2024–2025)

Mënyra	2024	2025
Nga njoftimet për punë në faqe interneti, media sociale, gazetë	13%	16%
Nga njohjet, lidhjet familjare, miqtë	69%	62%
Nga praktika profesionale në biznes	-	5%
Duke kontaktuar drejtpërdrejtë me punëdhënësin tim	6%	5%
Nga mësuesit	6%	-
Nga Zyra e Punësimit	-	3%
Tjetër	6%	5%

Shënim: *Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Baza: 2024 (N=32); 2025 (N=41).*

Lidhur me mbështetjen e shkollës në kapërcimin e fazës tranzitore drejt tregut të punës (Shiko tabelën 8), në 2024, 31% pohuan se shkolla i ka mësuar si të aplikojnë për punë, 31% pohuan se i ka orientuar mbi mundësitë e ndryshme të punësimit, dhe 17% pohuan se i ka ndihmuar për të vendosur kontakte me punëdhënës potencialë; 22% u shprehën se shkolla përgjithësisht nuk i ka ndihmuar. Në 2025, mësimi i kërkimit/aplikimit për punë u rrit në 44%, ndërsa orientimi mbi mundësitë e punësimit ra në 27% dhe ndihma për kontakte me punëdhënës ra në 5%; pjesa e atyre që deklarojnë mungesë ndihme ra lehtë, në 17%.

Tabela 8: Ndihma e shkollës në gjetjen e punës së parë (2024–2025)

Lloji i ndihmës	2024	2025
Kam mësuar si të kërkoj dhe të aplikoj për punë	31%	44%
Më ka orientuar mbi mundësitë e ndryshme të punësimit	31%	27%
Më ka ndihmuar për të vendosur kontakte me punëdhënës potencialë	17%	5%
Përgjithësisht nuk më ka ndihmuar	22%	17%

Lloji i ndihmës	2024	2025
Tjetër	11%	12%

Shënim: *Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Baza: 2024 (N=36); 2025 (N=41).*

Të diplomuarit që ndjekin kualifikime të mëtejshme

Të pyetur mbi arsyet e ndjekjes së studimeve të mëtejshme (Shiko tabelën 8), në 2024, 44% u përgjigjën për të fituar një kualifikim më të lartë, 33% për të rritur mundësitë për një punë më të mirë, dhe nga 11% për të ndjekur një karrierë tjetër profesionale ose sepse nuk gjenin dot punë. Në 2025, arsyeja kryesore u bë ndjekja e një karriere tjetër profesionale (50%), ndjekur nga fitimi i një kualifikimi më të lartë (25%) dhe pamundësia për të gjetur punë (25%); asnjë nuk përmendi rritjen e mundësive për punë më të mirë si arsye më vete.

Tabela 9: Arsyet kryesore për ndjekjen e kualifikimeve të mëtejshme (2024–2025)


Arsyeja	2024	2025
Për të fituar një kualifikim më të lartë	44%	25%
Për të rritur mundësitë për të gjetur një punë më të mirë	33%	-
Për të ndjekur një karrierë tjetër profesionale	11%	50%
Nuk po gjeja dot punë	11%	25%

Shënim: *Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Baza: 2024 (N=9); 2025 (N=7)*

Të diplomuarit pa punë

Niveli i të diplomuarve të papunë një vit pas diplomimit ra nga 31% (N=18) në 2024 në 22.4% (N=13) në 2025. Nga këta, pjesa që deklaron se është në kërkim aktiv të një pune ra lehtë, nga 61% (11 nga 18) në 2024 në 69% (9 nga 13) në 2025.

Figure 17: Niveli i të diplomuarve pa punë që kërkojnë për punë (2024-2025)



Shënim: *Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt baza 2024: N=18; 2025 (N=13).*

Krahasuar me vitin 2024, ku arsyet kryesore të papunësisë ishin mungesa e eksperiencës në punë (45%), mungesa e njohurive mbi mënyrën e aplikimit (27%) dhe mungesa e ofertave në rajon (18%), në 2025 arsyet e raportuara ndryshuan tërësisht drejt faktorëve strukturorë: mospërputhja e ofertave me arsimimin (25%), mungesa e njohjeve/kontakteve të duhura (25%) dhe angazhimi në punë familjare (25%).

Tabela 10: Arsyet kryesore të papunësisë (2024–2025)

Arsyeja	2024	2025
Më mungon eksperienca e punës	45%	-
Njohuritë e marra nga shkolla nuk përputhen me tregun e punës	-	-
Ofertat për punë nuk lidhen me arsimimin tim	-	25%
Nuk kam njohjet/kontaktet e duhura për të gjetur një punë	9%	25%
Nuk ka punë në qarkun tim	18%	-
Jam i/e angazhuar në punë familjare	-	25%
Tjetër	-	25%
Nuk kam burime të mjaftueshme për t'u vetë-punësuar	-	-
Nuk di si të kërkoj për punë	27%	-

Shënim: *Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Baza: 2024 (N=18); 2025 (N=13).*

Të pyetur për arsyet e mos kërkimit për punë (Shiko tabelën 11), në 2024, arsyeja kryesore ishte plani për t'u larguar nga vendi (43%), ndjekur nga mungesa e dëshirës për të punuar (14%) dhe pritja për të filluar punë së shpejti (14%). Në 2025, tri arsye ndaheshin në mënyrë të barabartë: mungesa e dëshirës për të punuar (25%), plani për t'u larguar nga vendi (25%) dhe aftësia ndryshe (25%).

Tabela 11: Arsyet kryesore të mos kërkimit për punë (2024–2025)

Arsyeja	2024	2025
Po pres të filloj punë së shpejti	14%	-
Nuk kam besim se do gjej një punë	-	-
Nuk kam dëshirë të punoj për momentin	14%	25%
Kam në plan të largohem nga vendi	43%	25%
Kujdesem për fëmijët/familjen	-	-
Jam me aftësi ndryshe	-	25%
Tjetër	29%	25%

Shënim: *Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Baza: 2024 (N=7); 2025 (N=13).*

Për vitin 2024, 72% e të diplomuarve të papunë kishin qenë më parë në një marrëdhënie pune, kundrejt vetëm 23% në 2025 - pra një rënie e ndjeshme e pjesës së të papunëve me përvojë pune të mëparshme.

Propozimet për përmirësim në shkollë

Të pyetur se për çfarë aspektesh ka nevojë për përmirësim shkolla (Shiko tabelën 11), në 2024 theksi ishte tek praktika në biznes (74%), bashkëpunimi me bizneset (69%), praktika në shkollë (67%) dhe aftësitë teorike/praktike të mësuesve (65%). Në 2025, niveli i përgjithshëm i nevojës për përmirësim u ul në pothuajse çdo aspekt, me përjashtim të këshillimit të karrierës (61%, tashmë prioriteti kryesor krahas metodave të mësimdhënies dhe aftësive të mësuesve, të gjitha në 61%).

Tabela 12: Përqindja e aspekteve ku ka nevojë për përmirësim në shkallë "shumë/jashtëzakonisht shumë" (2024–2025)


Aspekti	2024	2025
Infrastruktura	49%	48%
Kurrikula	53%	39%
Tekstet dhe materialet	54%	46%
Metodat e mësimdhënies	60%	61%
Aftësitë teorike dhe praktike të mësuesve	65%	61%

Aspekti	2024	2025
Praktika në shkollë	67%	59%
Praktika në biznes	74%	59%
Këshillimi i karrierës	56%	61%
Bashkëpunimi me bizneset	69%	53%
Bashkëpunimi me zyrat e punësimit	61%	55%

Shënim: *Baza: 2024 dhe 2025*

Nëse do të kishin mundësi, 71% e të diplomuarve në 2024 do të zgjidhnin të njëjtin drejtim profesional dhe 76% të njëjtën shkollë. Në 2025, kjo dëshirë u rrit: 78% do të zgjidhnin sërish të njëjtin drejtim dhe të njëjtën shkollë.

Figure 18: Përzgjedhja e së njëjtës shkollë dhe degë (2024-2025)



Shënim: *Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt baza 2024: N=58; 2025, N=58.*

Të ndara sipas drejtimit, përzgjedhja e së njëjtës degë u përmirësua ndjeshëm në shumicën e drejtimeve nga 2024 në 2025: Elektroteknika shënoi rritjen më të madhe, nga 70% në 100% (+30 pikë përqindje), e ndjekur nga Termohidraulika, nga 57% në 88% (+31 pikë përqindje) dhe SHMT, nga 88% në 100% (+12 pikë përqindje); TIK u rrit lehtë, nga 71% në 80% (+9 pikë përqindje). Mekanika mbeti e pandryshuar në 83% në të dy vitet, ndërsa Ndërtimi ishte i vetmi drejtim me rënie, nga 58% në 50% (−8 pikë përqindje).

Për sa i përket përzgjedhjes së së njëjtës shkollë, tabloja është më e përzier: Elektroteknika dhe SHMT u përmirësuan në të njëjtën masë si te dega (respektivisht nga 70% në 100%, dhe nga 88% në

100%), dhe TIK mbeti pothuajse i pandryshuar (79% në 80%). Ndërkohë, Termohidraulika pësoi rënien më të theksuar, nga 75% në 63% (−12 pikë përqindje), ndërsa Ndërtimi ra lehtë, nga 67% në 63% (−4 pikë përqindje); Mekanika, si te dega, mbeti e qëndrueshme në 83%.

Në përgjithësi, Elektroteknika dhe SHMT janë drejtimet me përmirësimin më konsistent të kënaqësisë ndaj zgjedhjes së bërë (si për degën ashtu edhe për shkollën), ndërsa Termohidraulika shfaq një sjellje të kundërt mes dy treguesve me rritje të fortë në përzgjedhjen e së njëjtës degë, por rënie në përzgjedhjen e së njëjtës shkollë.


Tabela 13: Përzgjedhja e së njëjtës degë dhe shkollë sipas drejtimit (2024-2025)

		Elektroteknikë	Termohidraulikë	Mekanikë	Ndërtim	SHMT	TIK
2024	Degë	70%	57%	83%	58%	88%	71%
	Shkollë	70%	75%	83%	67%	88%	79%
2025	Degë	100%	88%	83%	50%	100%	80%
	Shkollë	100%	63%	83%	63%	100%	80%

Shënim: *Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt, baza 2024 (N=58), 2025 (N=58).*

Të ndara sipas gjinisë, në 2024, 70% e djemve dhe 100% e vajzave do të përzgjidhnin të njëjtën degë; 75% e djemve dhe 100% e vajzave do të përzgjidhnin të njëjtën shkollë. Në 2025, 76% e djemve dhe 100% e vajzave do të përzgjidhnin të njëjtën degë dhe të njëjtën shkollë - pjesa e djemve u rrit lehtë, ndërsa vajzat mbetën në maksimum në të dy vitet.

Figure 19: Përzgjedhja e së njëjtës degë studimi dhe shkollë sipas gjinisë (2024-2025)



Shënim: *Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. baza 2024: (M N=56; F N=2); 2025 (M N=54; F N=4);*

Planet për të ardhmen

Të pyetur për planet e tyre për të ardhmen e afërt (Shiko tabelën 14), dëshira për të filluar biznesin personal ishte prioriteti kryesor në të dy vitet, dhe u rrit nga 45% (2024) në 50% (2025). Dëshira për t'u punësuar thjesht ra ndjeshëm, nga 17% (2024) në 16% (2025, pothuajse e pandryshuar), ndërsa dëshira për një punë të lidhur me fushën e studimit u rrit nga 19% (2024) në 24% (2025). Interesi për emigrim jashtë vendit u rrit lehtë (14% në 2024, 17% në 2025), ndërsa migrimi i brendshëm ra lehtë (9% në 2024, 7% në 2025). Interesi për studime të mëtejshme mbeti i qëndrueshëm (10% në të dy vitet).

Tabela 14: Planet e të diplomuarve për dy vitet e ardhshme (2024-2025)

Planet	2024	2025
Të jem punësuar	17%	16%
Të kem gjetur një punë që lidhet me fushën time të studimit	19%	24%
Të kem filluar biznesin tim	45%	50%
Të kem ndjekur studime të mëtejshme	10%	10%
Të kem emigruar jashtë vendit	14%	17%
Të kem migruar në një qytet tjetër brenda vendit	9%	7%
Tjetër	9%	7%

Shënim: *Baza: 2024 (N=58); 2025 (N=58).*

Rekomandime për forcimin institucional

Rekomandimet e mëposhtme lidhen drejtpërdrejt me gjetjet e raportit të gjurmimit për Shkollën Teknike Profesionale Korçë. Në të dy vitet janë gjurmuar nga 58 të diplomuar, por përbërja sipas drejtimeve ka ndryshuar. Për profilet me pak përgjigje dhe treguesit me mospërputhje, hapi i parë është verifikimi dhe sqarimi i situatës.

1. Të kuptohet punësimi jashtë profesionit

Njësia e Zhvillimit të diskutojë me të diplomuarit që punojnë jashtë fushës së studimit për pengesat që kanë hasur. Me bizneset partnere të identifikohen mundësi praktike dhe punësimi në profesion, veçanërisht për Mekanikën, Termohidraulikën dhe TIK-un.

Gjetja: Në 2025, 65.8% raportojnë se puna nuk lidhet me arsimin, nga 52.8% në 2024. Të 17 personat që iu përgjigjën pyetjes për arsyet deklarojnë se nuk gjetën punë në fushën e studimit. Rezultatet sipas profileve kërkojnë shqyrtim të bazave përpara përgjithësimit.

2. Praktikë dhe mësimdhënie që ndihmojnë përdorimin e aftësive

Ekipet lëndore të rishikojnë detyrat praktike dhe metodat e mësimdhënies me kontributin e bizneseve dhe të diplomuarve. Të identifikohen aftësitë që kërkohen në punë dhe mundësitë për t'i ushtruar më shumë gjatë shkollimit.

Gjetja: Përdorimi i njohurive "shumë/jashtëzakonisht shumë" ra nga 44% në 34%, ndërsa përgjigjet "aspak" u rritën nga 11% në 19.5%. Raporti paraqet nevojë për përmirësimin e metodave të mësimdhënies dhe aftësive të mësuesve nga 61% secila, dhe të praktikës në shkollë e biznes nga 59% secila; bazat e këtyre treguesve duhen plotësuar.

3. Orientim në karrierë me kontakte konkrete për punësim

Këshillimi për aplikimin për punë të shoqërohet me takime me punëdhënës, referime dhe ndjekje pas diplomimit. Të diplomuarit pa punë të kontaktohen individualisht për të përcaktuar mbështetjen që u nevojitet.

Gjetja: Ndihma e shkollës për vendosjen e kontakteve me punëdhënës ra nga 17% në 5%, ndërsa orientimi mbi mundësitë e punësimit nga 31% në 27%. Në 2025, 62% e kanë gjetur punën e parë përmes lidhjeve personale dhe vetëm 5% përmes praktikës në biznes. Nga 13 të diplomuarit pa punë, 9 kërkojnë punë.

4. Më shumë informacion për kontratat dhe sigurimet

Orientimi në karrierë të përfshijë sesione praktike për kontratat, kushtet e punës dhe verifikimin e sigurimeve. Në kontaktet pas diplomimit të identifikohen të diplomuarit që kanë nevojë për sqarim ose orientim drejt shërbimeve përkatëse.

Gjetja: Raporti paraqet 40.5% të punësuar pa kontratë, 13.5% që deklarojnë se nuk u paguhen sigurimet dhe 11% që nuk e dinë nëse u paguhen. Baza e vlefshme duhet verifikuar, pasi këto përqindje nuk përputhen me N=41 të shënuar.

5. Mbështetje praktike për interesin për sipërmarrje

Të diplomuarve që synojnë hapjen e një biznesi t'u ofrohet këshillim për zhvillimin e idesë, vlerësimin e tregut dhe planifikimin financiar. Të krijohen kontakte me sipërmarrës dhe shërbime mbështetëse sipas profilit.

Gjetja: Në 2025, 50% dëshirojnë të kenë filluar biznesin e tyre brenda dy viteve, ndërsa vetëm 4 nga 58 të diplomuarit janë aktualisht të vetëpunësuar. Ky dallim kërkon sqarimin e gatishmërisë dhe mbështetjes së nevojshme për konkretizimin e planeve.